



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1340/3 Prot.

Tiranë, më 28 . 12 . 2023

V E N D I M

Nr. 264 , datë 28 . 12 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 265 Regj., datë 14.12.2023, të shtetasit E. H¹, kundër Radio Televizionit Shqiptar, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër²”, për shkak të “gjendjes arsimore.”

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, E. H, evidentohet problematika e lindur mes tij dhe ish-punëdhënësit, Radio Televizionit Shqiptar (në vijim cituar si RTSH).

Nisur nga kronologjia e ngjarjeve e rrethanave të krijuara mes ankuesit dhe ish-punëdhënësit të tij, Radio Televizionit Shqiptar, konstatohet se:

- Në muajin dhjetor 2022, Radio Televizioni Shqiptar, ka shpallur pozicionin e lirë të punës “Drejtor Departamenti”, në Departamentin e Prodhimit.
- Ankuesi, E. H, në ndjekje të procedurave të konkurimit, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar, dhe në përfundim të procedurës është shpallur fitues.
- Pas kalimit me sukses të periudhës 3 (tre) mujore së provës, punëdhënësi ka nënshkruar me ankuesin kontratën individuale të punës, me afat të pacaktuar.

¹ Përfaqësuar nga Av. E. L, me prokurë të posaçme me nr. rep. 4088, dhe nr. koleksioni 1208, datë 27.10.2023.

² Pa përcaktuar, shpjeguar apo dokumentuar se çfarë pretendon a justifikon ankuesi me këtë shkak.

³ Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

- Në muajin qershor 2023, në krye të institucionit të RTSH-së u emërua A. P.
- Në muajin qershor-2 korrik 2023 u zhvillua Festivali Folklorik i Gjirokastrës, i cili ishte i një rëndësie të veçantë, pasi realizohej pas 8 (tetë) vitesh dhe është ekskluziviteti i RTSH-së.
- Me shkresën me nr. 1457 prot., datë 17.07.2023, ankuesi është njoftuar për takim, lidhur me zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës.
- Me vendimin me nr. 368, datë 03.08.2023 “Për zgjidhje të menjëhershme të marrëdhënieve të punës”, punëdhënësi ka vendosur: *“Zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës mes Radio Televizionit Shqiptar dhe E. H, me detyrë “Drejtor” në Departamentin e Prodhimit në RTSH, për “Mospërmbushje të detyrimeve dhe përgjegjësi të ngarkuara nga kontrata e punës dhe rregullorja e institucionit, parregullsi të theksuara në ushtrimin e detyrave, në mënyrë të veçantë lëvizjet e makinave dhe trajtimi me dieta i punonjësve si dhe mospasje e kualifikimit të duhur për pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Prodhimit, shkaqe këto të cilat nuk lejojnë sipas parimit të mirëbesimit vazhdimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të punës.”*

Subjekti ankues ka shpjeguar se, gjatë periudhës 6 mujore që ka qenë në pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Prodhimit, pranë RTSH-së, ka patur pasur rezultate dhe performancë shumë të mirë në punën e tij dhe se motivacioni i përdorur nga ish-punëdhënësi për largimin nga puna, nuk qëndron, është i pabazuar dhe i pavërtetë.

Ai citon ndër të tjera, se: *“Arsyetimet që ka dhënë RTSH-ja në shkresën e njoftimit për takimin për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës, si dhe në vendimin e zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës, janë shkaqe diskriminuese të cilat vendosin ankuesin në një pozitë diskriminuese, duke përmendur arsimin për vendin e punës, duke mos marrë parasysh eksperiencën 15 vjeçare, si dhe duke mos marrë parasysh faktin që vazhdon master shkencor. Për sa më sipër, lidhur me situatën kronologjike se si ka ecur ngjarja dhe arsyet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, besoj se jemi para një situatë diskriminuese, kjo për shkak të arsimit dhe çdo shkakut tjetër (duke patur parasysh shkresën e njoftimit për takim dhe vendimin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës).”*

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së tij, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Radio Televizionit Shqiptar, për shkaqet e pretenduara.

Pas pranimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues lidhur me shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues dhe për këtë arsye, me datë 06.12.2023, është kontaktuar av. E. L, përfaqësuesi ligjor i ankuesit, nga specialistja e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave dhe i është kërkuar të plotësojë informacionin e dokumentacionin e nevojshëm.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, përfaqësuesi ligjor i subjektit ankues, me datë 11.12.2023, ka dërguar kopje të dokumentacionit:

- Kopje e Diplomës bachelor dhe listës së notave, të Universitetit European të Tiranës (UET).
- Kopje të dokumentit “Vërtetim”, me nr. 488 prot., datë 01.02.2023, të UET-së.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare_ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore_ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në

përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë apo të padrejtë e të pafavorshëm të RTSH-së, vijnë për shkaqet e pretenduara, duhet që fillimisht këto shkaqe të jenë provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkaqe të njohura nga LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Komisioneri vlerëson se, personi i cili pretendon se është diskriminuar për këto shkaqe, por jo vetëm, duhet gjithashtu të parashtrojë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkaqet e mbrojtura, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, janë: gjendja arsimore dhe “çdo shkak tjetër”.

Së pari, sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh⁴. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁵.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturë të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i

⁴ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁵ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

Diskriminimi⁶ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Së dyti, subjekti ankues, në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, evidenton faktin se, zgjidhja e marrëdhënieve të punës nga ana e RTSH-së, ka ardhur për shkak të gjendjes arsimore të tij, duke patur parasysh me këtë motivacionin e deklaruar në vendimin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Ai ka shpjeguar se plotëson kriterin e arsimimit dhe kualifikimit të kërkuar për pozicionin e punës “Drejtor” i DP, në RTSH.

Bazuar në dokumentin “Diplomë Bachelor”, lëshuar nga Universiteti European i Tiranës, me datë 27.03.2023, vërtetohet se, E. H është diplomuar në Arte Skenike, me profil Regji dhe se data e përfundimit të studimeve universitare të ciklit të parë është me datë 12.07.2022. (Emerimin në detyrë e ka me datë 31.01.2023)

Sipas dokumentit me nr. 488 prot., datë 01.02.2023 “Vërtetim”, lëshuar nga Universiteti European i Tiranës, vërtetohet se ai ndjek programin e studimeve master i Shkencave të Komunikimit, në profilin Menaxhim Marketingu, për vitin akademik 2022-2023.

Po ashtu, bazuar në të dhënat e CV-së së dërguar prej tij, evidentohet se z. H ka një eksperiencë mbi 15 vjeçare në profilin e tij profesional.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të

⁶ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë⁷”

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi respektivisht edhe për shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e

⁷ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesi ka ngritur pretendime për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën pranë KMD-së, RTSH-së, duke pretenduar se është gjendur në një situatë diskriminuese, situatë e cila supozohet se ka si shkak gjendjen arsimore dhe çdo shkak tjetër (të pashpjeguar), me shpjegimin se: *“Arsyetimet që ka dhënë RTSH-ja për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, janë shkaqe diskriminuese, të cilat më vendosin në një pozitë diskriminuese duke përmendur arsimin për një vend duke mos marrë parasysh eksperiencën 15-vjeçare si dhe faktin që vazhdoj master shkencor”*.

Në kuptim të LMD-së, *“Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.”*⁸

Kështu, motivacioni i përdorur për justifikimin e zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës me ankuesin, nga ana e RTSH-së, është: *“Mospërbushje të detyrimeve dhe përgjegjësive të ngarkuara nga kontrata e punës dhe rregullorja e institucionit, parregullsi të theksuara në ushtrimin e detyrave, në mënyrë të veçantë lëvizjet e makinave dhe trajtimi me dieta i punonjësve si dhe mospasje e kualifikimit të duhur për pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Prodhimit, shkaqe këto të cilat nuk lejojnë sipas parimit të mirëbesimit vazhdimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të punës.”*

Pra, krahas shkeljeve të detyrimeve e përgjegjësive sipërcituar, është pretenduar, nga punëdhënësi edhe për mospasje të kualifikimit të duhur për pozicionin e punës Drejtor DP/RTSH, të cilat, të gjitha bashkarisht i kanë shërbyer atij si motivacion për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës.

Lidhur me sa më lart, si dhe me shpjegimet që jep ankuesi se ai plotëson kriterin e arsimit të kërkuar dhe se ka eksperiencë e kualikime të mjaftueshme për pozicionin e punës Drejtor i Departamentit të Prodhimit/RTSH, Komisioneri, vlerëson se, përmbushja e tyre është kërkesë e cila shkon në përputhje me kërkesat e këtij pozicioni pune dhe se, pasja apo posedimi i tyre nuk përbën një “shkak të mbrojtur” sipas LMD-së, në kuptimin që t’i kenë dhënë ankuesit një “status” apo t’i kenë veshur atij cilësi personale apo karakteristika të identifikueshme, të dallueshme individuale. Përmbushja e këtyre kërkesave është kriter paraprak dhe detyrim për emërimin e një punonjësi në këtë detyrë.

⁸ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Komisioneri vëren se, arsyetimi i përdorur nga RTSH-ja dhe motivacioni i zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me ankuesin, mund të lidhet me ligjshmërinë apo jo të veprimeve, apo vërtetësinë e argumenteve të dhëna prej punëdhënësit për lagimin e z. H nga puna, por nuk lidhen me cilësitë e karakteristikat e identifikueshme të ankuesit në kontekst të shkakut të mbrojtur sipas LMD-së.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër”, sipas kuptimit të LMD-së, nuk rezulton i provuar bazuar në provat e depozituara prej tij.

Pala ankuese nuk parashtron e argumenton bindshëm me fakte e prova, se mbart shkaqet e pretenduara, mbi të cilat të mund të vijohej me hetimin e ankesës, nëse ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të diferencuar nga ana e punëdhënësit, lidhur me zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës, trajtim i cili të jetë motivuar pikërisht nga gjendja arsimore dhe “çdo shak tjetër”, i provuar prej tij.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se:

“4. Ankesa nuk pranohet nëse:ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/ të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues E. H, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA